

LEDIA DUSHKU

**NËNSHKRIMI I PROTOKOLLIT TË KORFUZIT
DHE REAGIMI I SHQIPTARËVE
(MAJ - QERSHOR 1914)**

Në prag të nënshkrimit të Protokollit të Korfuzit...

Mbërritja e gjermanit Vilhelm Vid (Wilhelm Friedrich Heinrich von Wied), si princ i Shqipërisë nuk e qetësoi situatën në Shqipërinë e Jugut. Lëvizja Vorioepirote, e cila kundërshtonte vendimet e Fuqive të Mëdha, për bashkimin e krahinës së Korçës dhe të Gjirokastrës me shtetin shqiptar, vazhdoi. Dezertimi i ushtarëve grekë dhe shtimi i radhëve të “ushtrisë epirote” u bë masiv dhe gjithnjë e më pak i kamufluar. Ndërkohë që mosmarrëveshjet shqiptaro-greke shtoheshin dhe fryma e mosbesimit mes palëve rritej, Fuqitë e Mëdha i dhanë sërish dorën Greqisë.

Më 24 prill 1914, në dyert e Ministrisë së Jashtme greke mbërriti nota e të Mëdhenjve, e cila s’ ishte gjë tjetër veçse përgjigja që ata i jepnin kërkesave greke të parashtruara në notën e 21 shkurtit 1914¹. Në notën e prillit, shpallej gatishmëria e Fuqive të Mëdha për të mbështetur parimin e barazisë gjuhësore dhe fetare në Shqipëri, parim të cilin ato ia kishin rekomanduar edhe Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Fuqitë deklaroheshin të gatshme për të këshilluar qeverinë shqiptare që të vlerësonte sugjerimet e homologes greke në lidhje me rekrutimin e

¹ Nota greke e 21 shkurtit 1914 bënte me dije gatishmërinë e Greqisë për t’u pajtuar me vendimet e Fuqive të Mëdha për Shqipërinë dhe për të tërhequr në kohë, trupat e saj nga territoret e përcaktuara në Protokollin e Firences. Ajo deklaronte angazhimin formal për të mos bërë asnjë rezistencë dhe për të mos inkurajuar drejtpërdrejt ose tërthorazi ndonjë rezistencë kundrejt gjendjes së vendosur nga Fuqitë e Mëdha në Jug të Shqipërisë. Krahas angazhimeve, ajo paraqiste edhe disa kërkesa si: rektifikimi i kufijve në luginën e Gjirokastrës, “garancitë e mjaftueshme dhe efikase”, për të gjithë popullsinë ortodokse në Shqipëri dhe autonomia për zonën e Himarës. Për më shumë shih: Ledia Dushku, “Principata Shqiptare dhe qëndrimi i Greqisë (mars-prill 1914)”, *Studime Historike*, Nr. 1-2, Tiranë: 2011, f. 93-118.

elementëve lokalë në xhandarmëri. Nota shkonte edhe më tej, kur njoftonte se për rajonin e Gjirokastrës, Fuqitë e Mëdha ishin gati të vinin në jetë çdo marrëveshje të realizuar ndërmjet çdo njëres prej tyre dhe Greqisë. Duket se kishte edhe një zbutje të qëndrimit edhe në lidhje me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër sepse Të Mëdhenjtë shpreheshin se duheshin bërë vëzhgime për të parë nëse dëshirat e qeverisë greke mund të pajtoheshin me linjën e adaptuar, për Korçën². Nota u shoqërua dhe me një deklaratë verbale të përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Athinë, e cila vinte në pah dëshirën që qeveria greke “të fillojë menjëherë zbrazen e pjesës tjetër të Epirit, që është vendosur t’i jepet Shqipërisë”³.

Nota e 24 prillit i hiqte Athinës çdo shkas për ta vonuar tërheqjen e ushtrisë nga territoret e shtetit shqiptar. Sakaq, po në të njëjtën ditë, E. Venizelos (Eleftherios Venizelos) si ministër i Luftës urdhëroi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë greke për të kryer evakuimin⁴. Më 28 prill 1914, ministri i Jashtëm i Greqisë, Streit (Georgios Streit) njoftoi përfundimin e tërheqjes së ushtrisë greke nga “pjesa e Epirit që i ishte dhënë shtetit shqiptar”⁵.

Bisedimet shqiptaro-greke: njohja e qeverisë shqiptare dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike

Pikërisht në këtë situatë, qeveria greke vuri në lëvizje linjën e bisedimeve me Shqipërinë. Më 28 prill 1914, katër ditë pas notës përgjigje të Fuqive të Mëdha, përfaqësuesi grek në Vjenë i kërkoi ministrin të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë të influenconte pranë qeverisë shqiptare për të rifilluar bisedimet me Greqinë. E njëjta kërkesë

² Joseph Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Tiranë: “Dituria”, 2005, f. 170; Edith Stickney, *Shqipëria Jugore ose Epiri i Veriut në çështjet evropiane ndërkombëtare, 1912-1923*, Tiranë: “Koha”, 1998, f. 82.

³ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-VI-29, Lajme dhe dokumente mbi Luftën Epirotike, fl. 13.

⁴ *Po aty*.

⁵ *Ministere des Affaires Etrangères, Archives Diplomatiques* (më tej: *AMAE*) në *AIH*, F. 151, fl. 984, Telegram i Ministrisë së Jashtme të Greqisë për Legatën në Paris, Athinë, 28 prill 1914.

u bë edhe në Romë⁶. Në dukje, kishte një përpjekje nga pala greke për të ulur tonet e acaruar me qeverinë shqiptare dhe për t'u treguar Fuqive të Mëdha predispozitën pozitive që ajo kishte, për të pasur marrëdhënie të mira me Shqipërinë.

Ditët e fundit të prillit, Kostandin Varatasi (Kostandinos Baratas), delegati special i qeverisë greke, i mandatuar në shkurt 1914 për të negociuar me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, mbi procedurat e evakuimit, mbërriti sërisht në Durrës. Kësaj here me një mision të ri: vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë⁷. Dërgimi i tij në kryeqytetin shqiptar u prit me optimizëm në kancelaritë e Fuqive të Mëdha, të cilat mbështesnin zgjidhjen paqësore të problemeve, që shqetësonin Shqipërinë e Greqinë⁸. Por, në ambientet politike shqiptare, optimizmi nuk qe i lartë. Qeverinë shqiptare, më shumë se vendosja e marrëdhënieve diplomatike, e shqetësonte vazhdimi i Lëvizjes në Shqipërinë e Jugut, për të cilën ajo bënte përgjegjëse, Greqinë. Për këtë arsye, në takimin që kryeministri shqiptar, Turhan pashë Përmeti zhvilloi me Varatasin, e përqendroi diskutimin te Lëvizja në Jug duke përfshirë edhe lëshimet që qeveria shqiptare kishte menduar t'u bënte "vorioepirotëve". Duke lënë mënjanë mendimin që kishte mbi bizantinizmin e politikës greke dhe mosbesimin ndaj rolit ndërmjetësues të Varatasit, Përmeti i kërkoi të dërguarit grek t'u transmetonte atyre propozimet e qeverisë shqiptare⁹.

Ndonëse roli i ndërmjetësit nuk ishte i panjohur për të dërguarin grek, ai nuk e pranoi kërkesën e qeverisë shqiptare. Refuzimin e përligji me faktin se tashmë misioni i tij nuk konsistonte në vazhdimin e bisedimeve për "Epirin", por në fillimin e negociatave për vendosjen e

⁶ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.P.A.A.*) në *AIH*, Vj. 24-9-963, Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për përfaqësuesin në Durrës, Vjenë, 28 prill 1914.

⁷ *AMAE* në *AIH*, F. 152, fl. 1050-1053, Raport i anëtarit francez të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, Krajevski, për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Dumerg, Durrës, 1 maj 1914.

⁸ Timo Dilo, *Invazionet greke në Shqipërinë e Jugut* (dorëshkrimi në *AIH*, A-IV-330), fl. 129.

⁹ *AMAE* në *AIH*, F. 152, fl. 1050-1053, Raport i anëtarit francez të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, Krajevski, për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Dumerg, Durrës, 1 maj 1914.

marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve fqinje¹⁰. Qeveria greke e kishte dhënë urdhrin e evakuimit dhe këtej e tutje “nuk do të interesohej për çështje epirote”. Këshillat e saj “nuk dëgjoheshin” më as nga qeveria provizore, as nga oficerët, të cilët, pasi kishin dhënë dorëheqjen, ishin rekrutuar në “Batalionet e Shenjta”¹¹.

Kundërshtimi i Varatasit rriste andrallat për qeverinë e Durrësit. Ajo kishte pak dëshirë, për të mos thënë aspak, që të hynte në komunikim të drejtpërdrejtë me kryetarin e një qeverie kryengritësisë. Ndonëse kryeministri shqiptar ishte i gatshëm të dërgonte në Gjirokastër, ministrin e Drejtësisë dhe Fesë, Myfid Libohovën, ministrat e tjerë të kabinetit refuzonin të jepnin pëlqimin e tyre për bisedime të drejtpërdrejta¹². Edhe princ Vidi nuk kishte konsideratë të madhe për arritjen e një marrëveshjeje. Tashmë, ai nuk kishte besim as te grekët, as te Varatasi e as tek “epirotët”.

Lëshimet e qeverisë shqiptare nuk u njihnin territoreve jugore atë që Greqia pretendonte, karakterin etnik grek. Ato nuk jepnin garanci komprometuese për interesat kombëtarë shqiptarë dhe nuk cenonin unitetin e shtetit shqiptar. Si të tilla, propozimet shqiptare nuk mund të pranoheshin prej Varatasit, i cili nuk ishte i zhveshur nga fryma nacionaliste dhe konservatore, që gjallonte tek të gjithë ata që mbështesnin “çështjen epirote”¹³. Politika greke ishte ende shumë aktive për likuidimin e Shqipërisë së Jugut. Sipas konsullit francez në Korfuz, “ata që njohin tendencat e Varatasit dhe të Zografosit, të lidhur respektivisht me partitë e opozitës, u atribuojnë atyre një rol të ndjeshëm në dështimin e negociatave”¹⁴.

Pas miratimit në prill 1914 të Statutit Organik të Principatës Shqiptare vihet re një përpjekje në rritje e Athinës për ta anashkaluar qeverinë shqiptare dhe për të mbajtur kontakte të drejtpërdrejta me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit. Rivlerësimi i rolit të këtij të

¹⁰ *Po aty*, fl. 1065-1068, Raport i anëtarit francez të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, Krajevski, për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Dumerg, Durrës, 2 maj 1914.

¹¹ *Po aty*.

¹² *Po aty*.

¹³ *AMAE* në *AIH*, F. 151, fl. 1032-1037, Raport i konsullit francez në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Dumerg, Korfuz, 30 prill 1914.

¹⁴ *Po aty*.

fundit në zgjidhjen e “çështjes së Vorio-Epirit”, ndër të tjera, lidhej edhe me faktin se Statuti Organik i Principatës Shqiptare nuk e ridimensionoi rolin e tij. Mbështetur në vendimin përfundimtar të Konferencës së Ambasadorëve, të 29 korrikut 1913, Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit i besohej kontrolli i administratës civile dhe financave të Shqipërisë. Ai ishte organi më i lartë që do të merrej me organizimin administrativ dhe financiar të shtetit shqiptar, në një afat 10-vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje në rast nevojë¹⁵. Përpjekja greke ishte përforcuar edhe nga roli që Fuqitë e Mëdha i kishin ngarkuar Komisionit, në notën e 24 prillit të vitit 1914. Në këto kushte, i dërguari grek deklaroi në takim se Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit duhej lënë i lirë për të kryer misionin që i kishin ngarkuar Fuqitë e Mëdha¹⁶.

Përshtatja e politikës greke u shpreh shumë shpejt. Pas takimit me kryeministrin shqiptar, Varatasi takoi përfaqësuesin francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Krajevskin (Krawevski). Në një situatë të përzemërt dhe mirëbesimi, ai i dorëzoi këtij të fundit një kopje të propozimeve të radhës, të kryetarit të së ashtuquajturës Qeveri të Epirit Autonom, Zografos (Georgios Zografos)¹⁷. Krajevski ishte i mendimit se në tërësinë e tyre ato nuk mund të pranoheshin nga qeveria shqiptare.

¹⁵ Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit. Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik (1912-1918)* Vëllimi II, Tiranë: “8 Nëntori”, 1987, f. 278-279, Vendimi përfundimtar i Konferencës së Ambasadorëve, Londër, 29 korrik 1913.

¹⁶ AMAE në AIH, F. 152, fl. 1050-1053, Raport i anëtarit francez të Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Krajevski, për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Dumerg, Durrës, 1 maj 1914.

¹⁷ Në propozimet e Zografosit, krahinat e Gjirokastrës dhe të Korçës duhej të formonin një njësi të vetme ligjore, si prefekturat e tjera të shtetit shqiptar. Kujdesi dhe administrimi i brendshëm i pushtetit lokal duhej t’i jepej një bordi të zgjedhur lokal, që do të kryesohej nga Guvernatori, përfaqësues i qeverisë shqiptare. Guvernatori, i cili duhej të dinte greqisht, do të emërohej dhe shkarkohej nga Princi. Krahinat jugore të shtetit shqiptar duhet të merreshin në dorëzim nga xhandarmëria lokale, deri në formimin e së cilës, një komision i përbërë nga myslimanë dhe të krishterë do të kujdesej për sigurinë publike. Mësimdhënia në shkollat e komunitetit ortodoks në Shqipëri duhej të bëhej në greqisht, me përjashtim të tri klasave fillore ku mësimi do të zhvillohej edhe në shqip. Për tekstin e plotë të propozimeve të Zografosit shih: Romeo Gurakuqi, *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë, 1913-1914. Çështja e Shqipërisë së Jugut ose e “Vorio Epiri” (nga 11 gusht 1913 deri më 31 tetor 1914)*, Tiranë: UET Press, 2011, f. 187-188.

Nëse kjo e fundit do të pranonte sistemin krahinor, nesër mirditasit dhe të tjerët do të kërkonin të njëjtin privilegj; ky do të ishte çorganizim dhe fundi i unitetit shqiptar¹⁸.

Ditët e para të majit, i dërguari grek kontaktoi zyrtarisht me ministrin Libohova. Ky ishte takimi i parë mes dy qeverive fqinje, pas njohjes së qeverisë shqiptare nga ajo greke. Greqia e njohu e dyta qeverinë shqiptare, pas Rumanisë, e cila e kishte njohur më 18 prill 1914¹⁹. Datën e njohjes, dokumentacioni që disponoj, nuk e përmban. Në kontaktet e shkruara diplomatike të majit 1914, Varatasi nuk cilësohet më si delegat, por si ministër i Greqisë në Shqipëri, cilësim ky, që të lë të kuptosh se Greqia jo vetëm që kishte njohur qeverinë shqiptare, por edhe kishte vendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë. Një muaj më vonë, në qershor të vitit 1914 Mehmet Konica u emërua si ministër i Shqipërisë në Oborrin e Greqisë²⁰.

Takimi Libohova-Varatasi vuri edhe një herë në tavolinën e bisedimeve shqiptaro-greke propozime të skajshme dhe të papranueshme për palët. Kështu, ministri grek propozoi që gjuha zyrtare në shërbimet e krahinave të Korçës dhe Gjirokastrës të ishte greqishtja dhe shqipja; oficerët e xhandarmërisë të këtyre krahinave të ishin ortodoksë sa më shumë të ishte e mundur dhe kryeadmirali i flotës greke, arvanitasi prej Hidre, Pavël Kondurioti, të emërohej si inspektor për krahinat e Korçës dhe të Gjirokastrës²¹. Nga ana e saj, pala shqiptare mbështeti fort lëshimet e bëra në mes të prillit të 1914-ës. Ajo nuk pranoi asnjë prej kërkesave të mësipërme²². Në këtë situatë, qeveria shqiptare i konsideroi të pafrytshme bisedimet me përfaqësuesin grek. Ajo nuk pranoi të vazhdonte më tej, duke përdorur argumentin se bisedimet i jepnin dorë qeverisë greke për të ndërhyrë në punët e brendshme të Shqipërisë.

¹⁸ AMAE në AIH, F. 152, fl. 1065-1068, Raport i anëtarit francez të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, Krajevski për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Dumerg, Durrës, 2 maj 1914.

¹⁹ Arben Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912-1914)*, Tiranë: "8 Nëntori", 1978, f. 593.

²⁰ *Po aty*, f. 595.

²¹ T. Dilo, *Invazionet greke.....*, fl. 149.

²² HHSStA.PA.A në AIH, Vj. 24-1-196, Raport i përfaqësuesit të Austro-Hungarisë në Durrës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Durrës, 3 maj 1914.

Qeveria shqiptare “dorëzohet”: Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit merr në dorë bisedimet me “vorioepirotët”

Presioni i Fuqive të Mëdha pranë qeverisë shqiptare për t'i dhënë fund Lëvizjes sa më shpejt, me anën e bisedimeve, u bë i fortë dhe i vazhdueshëm. Edhe gjendja në Jug nuk po njihte përmirësim. Qeveria e Durrësit zotëronte mjete të pakta ushtarake dhe ekonomike²³. Forcat e saj në Shqipërinë e Jugut përbëheshin prej rreth 2.500-3.000 xhandarësh nën drejtimin e oficerëve holandezë dhe disa mijërave jugorëve besnikë, drejtuesit e të cilëve bashkëpunonin me forcat e rregullta²⁴. Suksesi i veprimeve ushtarake shqiptare ishte i pasigurt. Andartët, me ndihmën e trupave të rregullt grekë po zmbrahnin xhandarmërinë shqiptare të pastërvitur dhe të pajisur keq.

Pasiguria për suksesin e forcave shqiptare bëhej më e madhe edhe për shkak të propagandës gjalluese greke. Propaganduesit e përdorën qëllimisht faktin që shumica e banorëve të krishterë të Shqipërisë së Jugut ishin anëtarë të kishës ortodokse. Si rezultat i një pune të kahershme, besnikëria e një pjese të popullsisë ortodokse ndaj “Shqipërisë myslimane dhe në anarki”, nuk mund të ishte shumë e fortë²⁵. Në Shqipëri vepronin qindra priftërinj, një pjesë e të cilëve vullnetarisht ishin informatorë të mitropolitit të Durrësit, Jakovi²⁶, i cili mbante lidhje me Varatasin. Ky i fundit organizonte nëpërmjet agjentëve të tij edhe shpërndarjen e të hollave për të zhvilluar propagandë kundër shqiptarëve dhe shtetit të tyre²⁷.

E pafuqishme për të kundërshtuar ndërkombëtarët dhe e paaftë për të stabilizuar dhe siguruar një qeverisje të efektshme në territoret jugore, qeveria shqiptare kishte vendosur të bindej dhe t'i rikthehej edhe një herë linjës së bisedimeve, tashmë të tërthorta me anën e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Për të marrë një vendim, ditët e para të majit të 1914 u zhvillua një mbledhje e qeverisë. Krahas anëtarëve të kabinetit

²³ Mustafa Kruja, *Antologji Historike*, Elbasan: “Sejko”, 2001, f. 282.

²⁴ D. Heaton Armstrong, *Shqipëri-1914. Gjashtë muaj Mbretëri*. (Kujtimet e sekretarit të princ Vedit), Tiranë: Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, 2001, f. 41.

²⁵ Tom J. Winniffrith, *Badlands-Borderlands: A history of Southern Albania / Northern Epirus*, London: Duckworth Publishers, January 2003, f. 130-131.

²⁶ Mehdi Frashëri, *Kujtime (vitet 1913-1933)*, Tiranë: “OMSCA-1”, 2005, f. 13.

²⁷ *HHSStA.PA.A. në AIH*, Vj. 24-41-4129, Njoftim i fshehtë për Ambasadën e Italisë në Vjenë, Vjenë, 29 korrik 1914.

në të mori pjesë edhe delegati në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Mehdi Frashëri. Në kujtimet e tij, ai shkruan: "...në mbledhje u bisedua çështja e marrëveshjes me Zografosin, me anën e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit"²⁸. Mbledhja vendosi që Mehdi Frashëri t'i propozonte Komisionit që të ndërmjetësonte me anën e Varatasit për një marrëveshje me Zografosin. Po sipas delegatit Frashëri, propozimi i qeverisë shqiptare për marrëveshje me "epirotët" ishte i pritshëm për anëtarët e Komisionit, të cilët e dinin që qeveria shqiptare nuk mund të bënte ndryshe.

Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit pranoi t'i merrte në dorë bisedimet me "vorioepirotët", veprim ky, që gjente mbështetje edhe në legjislacionin për rolin dhe funksionet e tij. Më 5 maj 1914, delegati gjerman pranë Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit njoftoi telegrafisht qeverinë e tij se ishte vendosur që të përdorej sërish Varatasi për të bërë provën e një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë me epirotët²⁹. Zgjidhja e çështjes pretendohet të bëhej në dy faza. Fillimisht, koncesionet do të caktoheshin me ministrin e Greqisë në Durrës dhe mandej Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit do të shkonte në Jug dhe do të finalizonte marrëveshjen me autonomistët.

Më 6 maj 1914, zyrtarisht qeveria shqiptare autorizoi Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, që në emër të saj, të hynte në kontakte me qeverinë e Zografosit. Ajo i dorëzoi atij "Dëshiresën", materialin e përgatitur prej saj, mbi bazën e së cilës Komisioni do të duhej të kryente bisedimet. Në "Dëshiresë", qeveria shqiptare pranonte që:

"Në shkollat e komuniteteve ortodokse të shtetit shqiptar mësimi do të bëhej në gjuhën greke, përjashtuar tri klasat e para të fillores, të cilat do të zhvillonin mësim në gjuhën shqipe. Megjithatë, edhe në këto tri klasa, mësimi i fesë do të bëhej në greqisht, e cila do të mësohej si gjuhë për t'u kuptuar nga nxënësit;

Marrja në zotërim e territoreve të zbrazura ose që do të zbrazen prej trupave grekë do të bëhej nga oficerët holandezë, të cilët do të shkonin atje dhe do të organizonin xhandarmërinë të përbërë nga elementë lokalë, numri i të cilëve do të jetë në përpjesëtim me besimin fetar. Deri në formimin e xhandarmërisë, pushteti do të ushtrohej nga Zografosi;

²⁸ M. Frashëri, *Kujtime...*, f. 12.

²⁹ T. Dilo, *Invazionet greke.....*, fl. 150.

Qeveria shqiptare do t'ia besonte një komisar detyrën për të marrë në zotërim rrethet e Korçës dhe të Gjirokastrës, i cili do të organizonte administratën;

Do të pranoheshin peticionet në gjuhën greke drejtuar këtij komisari;

Xhandarmëria shqiptare do të formonte një unitet nën një komandë të vetme. Në rrethet e Korçës dhe të Gjirokastrës do të përdreshin më tepër elementë të vendit;

Elementët lokalë nuk do të mënjanoreshin në zgjedhjen e funksionarëve;

Qeveria shqiptare do të ishte gati të merrte në shërbim të saj edhe ndonjë oficer të Greqisë, që rridhte nga familjet shqiptare, që kishin emigruar atje gjatë shekujve;

Rrethet e Korçës dhe të Gjirokastrës do të formonin një person juridik, sikurse edhe prefekturat e tjera të Shqipërisë. Ato do të kishin këshillat vendorë që do të kryesoheshin prej qeveritarëve që përfaqësonin qeverinë shqiptare;

Të 2.5 milionat që Greqia pretendonte t'i jepte Shqipërisë do të përdreshin kryesisht për të ndihmuar popullsinë e këtyre rrethëve³⁰.

Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit mirëpriti rolin e ndërmjetësit dhe menjëherë i dërgoi një telegram Zografosit, ku e njoftoi mbi garancitë që merrte përsipër qeveria shqiptare, me kushtin e prerë të ndërprerjes së menjëhershme të çdo avancimi dhe të çdo veprimi armiqësor në Jug³¹. Përgjigja ishte e menjëhershme. Kryetari i autonomistëve pranoi të ndërpriste veprimet e armatosura duke kërkuar të njëjtën gjë edhe nga pala shqiptare³². Më 7 maj 1914, luftimet në Shqipërinë e Jugut u ndërpreën dhe nisi përcaktimi i zonës neutrale³³.

Në situatën e krijuar, Zografoja nuk mund ta refuzonte ndërmjetësinë e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Madje, ai duhej të bashkëpunonte dhe të merrej vesh me anëtarët e tij. Gjendja edhe për të

³⁰ *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-41-4142, "Dëshiresa" e qeverisë shqiptare.

³¹ Vasilis Kondis, *Shqipëria dhe Greqia në Shekullin e XX*, Selanik: "Paratiritis", 1997, f. 70.

³² Κοστανδίν Σκενδέρης, *Ο Βορειοηπειρωτικός αγών 1914*, Athens: 1930 (Shfrytëzuar materiali në: *AIH*, shifra Kostandin Skënderis, *Lufta për Epirin e Veriut në vitin 1914*, Athinë, 1930, fl. 126).

³³ *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (F.) 434 (Mehdi Frashëri), Dosja (D.) 12, fl. 7, Telegram i Mehdi Frashërit për Turhan pashë Përmetin, Korfuz, 9 maj 1914.

ashtuquajturën qeveri të Epirit të Veriut ishte përkeqësuar. Kishte filluar të ndihej mungesa e armatimit dhe pasojat e zgjatjes së luftimeve³⁴. Paniku kishte mbërthyer popullsinë, e cila po braktiste vendin, duke kaluar një pjesë në Greqi, pjesa tjetër në zonat shqiptare jashtë konfliktit. Sinjale pozitive për hyrjen në bisedime kishin mbërritur dhe nga qeveria greke. Kryetari i autonomistëve kishte marrë udhëzime prej saj, në dobi të arritjes së një marrëveshjeje me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit³⁵. Moszhvillimi apo më keq se kaq, ndërprerja e tyre, mund të provokonin një hetim ndërkombëtar, apo një ndërhyrje ushtarake nga dy Fuqitë e Adriatikut, të cilat kishin njoftuar se do të kishte një pushtim të Epirit nëse kishte ndërprerje të bisedimeve³⁶.

Fuqitë e Mëdha kishin interes që bisedimet të përfundonin me marrëveshje. Franca dhe Britania e Madhe, të zëna me fushatat zgjedhore, dëshironin të kishin sa më pak preokupime në çështjet dytësore. Duke marrë parasysh tensionin mes Greqisë dhe Perandorisë Osmane, Italia rrekej ta shfrytëzonte momentin. Ajo paramendonte se në atë çast Greqia do të kërkonte më pak, sesa në një kohë më të favorshme, që mund të vinte nga një fitore e mundshme në ishujt e Egjeut ndaj Perandorisë Osmane³⁷. Pavarësisht se zhvillimi i bisedimeve shkonte në favor të legjitimitetit të “qeverisë së Epirit Autonom”, anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit ishin të vetëdijshëm që duke negociuar me të, “në të vërtetë po e bënin këtë me qeverinë greke dhe jo me atë të epirotëve apo të shqiptarëve të jugut”³⁸. Sipas delegatit britanik në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, H. Lamb (Harry Lamb), të gjithë anëtarët e Komisionit e kishin fort të qartë se “qeveria vorioepirote në Gjirokastër më parë apo në Korfuz më vonë, shërbente si një paravent i qeverisë greke”³⁹.

³⁴ *AIH*, A.IV.296, Procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë Epirote në Delvinë, botuar në gazetën “Amyra” në muajt korrik, gusht, shtator 1915.

³⁵ *AMAE* në *AIH*, F. 152, fl. 1251-1257, Raport i konsullit francez në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Dumerg, Korfuz, 19 maj 1914.

³⁶ J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie...*, f. 172.

³⁷ *HHS.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-9-927, Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Itali për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 13 maj 1914.

³⁸ J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie...*, f. 173.

³⁹ A. Puto, *Pavarësia e Shqipërisë...*, f. 591.

Bisedimet në ishullin grek: Nënshkrimi i Protokollit të Korfuzit

Bisedimet e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit me “qeverinë e Zografosit” filluan mëngjesin e 9 majit në Hotel d’Angleterre, në Korfuz. Për shkak të kushteve jo të përshtatshme për strehimin e anëtarëve të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, bisedimet nuk u mbajtën në Sarandë. Zhvillimi i tyre në ishullin grek me të drejtë shqetësoi shqiptarët dhe tregoi pozitën e dobët dhe të pafavorshme në të cilën ata ndodheshin. Qenia e Korfuzit afër me rrethet zyrtare greke favorizonte pozitën e “vorioepirotëve”. Prania e qeverisë greke në ishull ishte e dukshme. Krahas, ministrit të Greqisë në Durrës, atje kishin mbërritur ministri i Jashtëm grek, Streit, dhe përfaqësuesi i Greqisë në Berlin, Theotoki, njeri i besueshëm për gjermanët dhe mik i Kajzerit.

Nga ana e qeverisë shqiptare merrte pjesë vetëm përfaqësuesi i saj në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Mehdi Frashëri, njëkohësisht kryesues i tij. Nga “vorioepirotët” pjesëmarrës ishin J. Zografoja, në cilësinë e kryetarit të qeverisë epirote, Dh. Karapanosi, si ministër i Jashtëm, Dhulisi, si ministër i Luftës, dhe S. Spiromilos, si komandant i operacionit në Epir.

Duke iu nënshtruar një ndjenje delikatese, e konsideruar prej anëtarit francez të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit si e lavdërueshme, delegati shqiptar hoqi dorë nga kryesimi i Komisionit dhe pati dashamirësinë të caktonte kolegun e tij francez për ta kryer një funksion të tillë. Por bisedimet nuk u dominuan nga mirësjellja dhe vullneti i mirë i Zografosit. Që në kontaktin e parë ai mbajti një “qëndrim intransigjent e të turpshëm”, që, “po të lejohej të rridhte lirshëm, do të kishte bërë të pamundur çdo ide pajtimi”⁴⁰. Atij i mungoi qetësia dhe gjakftohtësia e domosdoshme për bashkëbisedime delikate, u rrëmbye nga rrjedha e fjalëve të tij, rëndësinë e të cilave ai nuk dinte ta llogariste. Foli “për pushtim të Epirit nga Fuqitë e Mëdha”, për “padrejtësi evropiane”, për “të drejta të epirotëve”, duke harruar se kishte para tij përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha dhe se vetë ai nuk ishte pjesëtar i popullsisë së Shqipërisë së Jugut që nga dita kur kishte adoptuar kombësinë e shtetësinë greke⁴¹. Sjellja arrogante dhe agresive e tij prodhoi efekte irrituese në thuajse të

⁴⁰ *AMAE* në *AIH*, F. 152, fl. 1191-1201, Raport i anëtarit francez të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, Krajevski, për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Dumerg, Korfuz, 10 maj 1914.

⁴¹ *Po aty*.

gjithë anëtarët e Komisionit. Qëndrim më të ekuilibruar mbajti Karapanosi. Si funksionar me karrierë të pasur diplomatike, ai me shumë takt u përpoq të eliminonte të metat e shefit të tij.

Që në takimin e parë, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit u paraqiti “përfaqësuesve të Epirit të Veriut”, “Dëshiresën” e qeverisë shqiptare. Prerazi, ajo nuk u pranua prej tyre. Kryeministri vorioepirot insistoi në privilegje të gjera, të cilat kërkonin t’i njihnin krahinës karakterin e pretenduar grek⁴². Orvatja kryesore kishte si objektiv bashkimin e dy provincave jugore, Korçën e Gjirokastrën, në një tërësi administrative, me një përfaqësi provinciale të përbashkët⁴³. Në tërësinë e tyre kërkesat e paraqitura nga Zografosi kishin si qëllim vendosjen e një autonomie të plotë administrative. Si të tilla, ato nuk pajtoheshin me unitetin e shtetit shqiptar nuk kishin pika takimi me “Dëshiresën” e qeverisë shqiptare.

Për të evituar rifillimin e përpjekjeve të armatosura, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit i vuri vetes për detyrë të afronte sa më shumë të ishte e mundur pikëpamjen e autonomistëve me atë të qeverisë shqiptare⁴⁴. Mendimi mbizotërues tek anëtarët e tij shkonte në favor të decentralizimit, çka solli propozime, të cilat i tejkaluan garancitë e qeverisë shqiptare.

Pavarësisht kësaj, Zografosi këmbënguli që medoemos Fuqitë e Mëdha të garantonin zbatimin e marrëveshjes, që pritej të arrihej⁴⁵. Më 17 maj 1914, përmes prefektit të Korfuzit, ai lajmëroi qeverinë greke mbi

⁴² Propozimet e Zografosit përfshinin: “Guvernatori i përgjithshëm i Korçës dhe i Gjirokastrës duhet të jetë i krishterë. Prefektët dhe kryetarët e gjykatave po ashtu. Vende vartësish mund të mbajnë edhe myslimanët. Gjuhë gjyqësore zyrtare do të jetë gjuha greke dhe kjo do të vazhdojë të përdoret edhe në çështjet që u përkasin myslimanëve. Gjuha greke do të jetë e detyrueshme në shkolla, kurse gjuha shqipe do të mësohet në mënyrë fakultative. Gjuha greke do të jetë gjuhë zyrtare e kishës. Do të formohet xhandarmëri lokale, e cila nuk do të mund të zëvendësohet me xhandarmërinë shqiptare ose me korpus ushtarak shqiptar. Epirotët nuk do të detyrohen për shërbim ushtarak, as në rast lufte. Myslimanët e Epirit do të gëzojnë të drejta të njëjta. Liria shkollore dhe kishtarë shtrihet edhe në grekët e Vlorës dhe të Durrësit. Portet e Sarandës dhe të Himarës do të shpallen porte të lira”. K. Σκενδέρης, *Ο Βορειοηπειρωτικός αγών 1914...*, fl. 127-128.

⁴³ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), Viti 1914, Dosja. 23, fl. 1-2. Shënime të një anëtari të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në lidhje me bisedimet e Korfuzit.

⁴⁴ T. Dilo, *Invazionet greke.....*, fl. 154.

⁴⁵ V. Kondis, *Greqia dhe Shqipëria...*, f. 71.

amendamentin e papranueshëm që përfaqësuesi italian kishte bërë lidhur me nenin, që kishte të bënte me garancitë e Fuqive të Mëdha. Ai iu lut asaj që t'i dërgonte municion dhe armë, të cilat i mungonin. Sipas studiuesit grek V. Kondis (Basil Kondis), Zografosit i duheshin armët për të mbrojtur integritetin tokësor të krahinës, në rast se bisedimet dështonin dhe rifillonin operacionet luftarake⁴⁶. Në përgjigjen e shpejtë që mbërriti nga Athina, kryeministri Venizelos këmbënguli që bisedimet të mos ndërpriteshin për asnjë arsye, madje edhe në rast se Fuqitë e Mëdha nuk pranonin të merrnin përsipër garantimin e marrëveshjes. Greqia nuk do të përzihej në çështjen e furnizimit me armatime dhe “epirotëve” duhej t'u bëhej e qartë se sigurimi i koncesioneve të premtuara mund të bëhej jo përmes garancive të Fuqive të Mëdha, por me anën e marrëdhënieve miqësore të Greqisë dhe Shqipërisë.

Qëndrimi i vendosur i Venizelosit tregoi se në atë moment qeveria greke nuk ishte e prirur të përkrahte “kokëfortësinë” e Zografosit. Dalja kundër vullnetit të Fuqive të Mëdha dhe veçanërisht një ndërhyrje e armatosur nga Fuqitë e Adriatikut ishin kosto, të cilat qeveria greke nuk ishte e gatshme t'i merrte përsipër. I ndier i braktisur prej fuqisë zyrtare të shtetit grek, Zografoja u detyrua që së bashku me Karapanosin, të nënshkruante më 17 maj 1914, marrëveshjen. Protokollin e Korfuzit⁴⁷, emri me të cilin njihet marrëveshja, do të miratohej *ad referendum*. Ajo do të hynte në fuqi vetëm pas pranimit nga njëra anë nga qeveria shqiptare dhe qeveritë e Fuqive të Mëdha dhe nga ana tjetër, nga asambleja e Epirit.

Protokollin e Korfuzit ishte rezultat i përpjekjeve të Fuqive të Mëdha për të gjetur një zgjidhje kompromisi, që do të mund të stabilizonte gjendjen në Shqipërinë e Jugut dhe do të kënaqte Greqinë. Në sajë të Protokollit, shteti shqiptar siguroi marrjen në dorëzim të territoreve të Shqipërisë së Jugut, ndërsa grekët arritën ta shpëtonin “çështjen e helenizmit”⁴⁸. Dispozitat e tij, ndonëse konfirmuan tërësinë territoriale të shtetit shqiptar, u dhanë territoreve jugore, autonominë administrative. Protokollin legalizoi konceptin e popullsisë vorioepirote, të cilën e veçonte

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ Për tekstin e Protokollit të nënshkruar më 17 maj 1914 në Korfuz, shih: A. Puto, *Çështja shqiptare në...*, Vëll. II, f. 614-617.

⁴⁸ *HSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-14-1458, Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Athinë, 28 maj 1914.

nga pjesa tjetër e popullsisë shqiptare⁴⁹ dhe i siguroi Greqisë të drejtën për t'u interesuar për të⁵⁰. Qeveria greke e shihte Protokollin si një mjet të përkohshëm, i cili, ndërkohë që u jepte liri të plotë propagandistëve grekë, duhej të zgjaste deri sa të paraqitej një mundësi për të aneksuar rajonin në fjalë⁵¹. Për anëtarin britanik në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Lemb, “marrëveshja nuk bazohej mbi asgjë reale dhe vendmbërritja përfundimtare e saj ishte e qartë”⁵². Pesë vjet pas nënshkrimit të Protokollit, në një nga seancat e Konferencës së Paqes, kryeministri grek, Venizelos, do të shprehej se Protokollin e Korfuzit u njihte territoreve jugore të shtetit shqiptar karakterin kombëtar grek, duke dëshmuar se nuk ishte fjala për territore shqiptare⁵³. Këtë fakt ai e konstatonte në tërësi në nenet e Protokollit.

Dispozitat e Korfuzit do të vepronin mbi popullsinë e Shqipërisë së Jugut që ishte mbajtur e pushtuar nga ushtria greke. Në to parashikohej shndërrimi i bandave “epirote” në xhandarmëri lokale, që do të ushtronte detyrat e veta vetëm në rrethet e Korçës e të Gjirokastrës. Veçse kjo xhandarmëri do të komandohej nga oficerët holandezë. Në përbërje të saj do të ishin edhe vullnetarët, që për momentin ishin nën armë, por që do të përfitonin amnisti të plotë dhe absolute për të gjitha veprimet e kryera. Forca e armatosur e Shqipërisë nuk kishte të drejtë të shkonte në “Epir” dhe anasjelltas. Gjuha shqipe do të mësohej paralel me greqishten dhe mësimi i fesë do të bëhej në gjuhën greke.

Protokollin e Korfuzit në thelb e kthente çështjen e krahinave jugore shqiptare në një problem ndërkombëtar. Në Dispozitat e tij, pozita e Princit dhe qeverisë shqiptare karshi Komisionit Ndërkombëtar ishte inferiore. Vidi, pavarësisht se ishte hegjemon i territoreve të Shqipërisë së Jugut, në thelb nuk kishte asnjë lloj pushteti mbi to⁵⁴. Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit iu besua përcaktimi i kufijve të provincave të Korçës dhe të Gjirokastrës, organizimi i administratës publike, financiare dhe të drejtësisë si dhe ekzekutimi dhe respektimi i protokollit. Qeveria

⁴⁹ A. Puto, *Pavarësia e Shqipërisë...*, 212-213.

⁵⁰ *AIH*, A-IV-213, fl. 78.

⁵¹ J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie...*, f. 173.

⁵² *Po aty*.

⁵³ Σ. Ι Στεφανου, Πολιτική υποθήκη του Ελευθερίου Βενιζέλου. Vol. II, Athens: 1969 (Shfrytëzuar materiali në *AIH*, A-V-100, S, I. Stefanu, *Amanetet politike të Eleftherio Venizelosit*, Vëll. II, Athens: 1969, fl. 207).

⁵⁴ V. Kondis, *Greqia dhe Shqipëria...*, f. 72.

shqiptare ruante vetëm të drejtën të emëronte dhe shkarkonte të gjithë guvernatorët dhe zyrtarët e lartë në përpjesëtim me ndikimin relativ të dy feve, por edhe këtë në marrëveshje me Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit. Pavarësisht nga sa më sipër, delegati shqiptar Frashëri e nënshkroi protokollin pa deklaruar asnjë rezervë ndaj tij, fakt ky që tregonte pozitën e dobët dhe të nënshtruar të shtetit shqiptar.

Dispozitat e Korfuzit ishin një paketë aktesh në të cilën krahas marrëveshjes bazë u përfshinë edhe tri dispozita shtesë (nr. 14, 15, 16), për krahinën e Himarës. Në Korfuz, Spiro Spiromiloja, Zografosi dhe Karapanosi i kërkuan Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit jo vetëm ruajtjen e privilegjeve të vjetra, që himarjotët kishin gëzuar në Perandorinë Osmane⁵⁵, por edhe një sërë privilegjesh të reja, si: një guvernator të huaj të krishterë, që do të mbante titullin “kapedan”; përjashtimin nga shërbimi ushtarak; arsimim vetëm në gjuhën greke; përjashtimin nga tagri doganor të import-eksportit; çështjet juridike të ushtroheshin nga këshillat lokalë të pleqësisë duke pasur edhe një gjyqtar pajtues me kompetenca të gjera në instancën e parë dhe të fundit⁵⁶.

Propozimet e mësipërme hasën në kundërshtimin e anëtarëve të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, çka solli përshtatjen e tyre. Propozimet e reja kërkonin sërish “ruajtjen e privilegjeve të lashta që himarjotët gëzonin nën regjimin otoman”. Distrikti i Himarës duhej të përfshinte 18 lokalitete, të cilat nga pikëpamja administrative duhej të lidheshin me atë të Gjirokastrës. Për një periudhë 10-vjeçare, guvernatori i Himarës duhej të ishte i huaj. Ai mund të ishte edhe oficeri holandez, i cili do të komandonte xhandarmërinë e Himarës⁵⁷. Xhandarmëria himarjote nuk duhet të përdorej në asnjë rast jashtë caqeve të krahinës së Korçës dhe të Gjirokastrës. Delegati shqiptar në Komisionin

⁵⁵ Privilegjet e vjetra për krahinën e Himarës i përkisnin vitit 1510. Ato bazoheshin në iraden e sulltan Selimit I, të ricikluara në vitin 1570 prej Selimit III. Privilegjet u siguronin himarjotëve: mbajtjen e armëve; autonominë komunale; flamur të veçantë vetëm në luftime; kufizimin e të gjitha tatimeve të drejtpërdrejta në një shumë fikse prej 12.000 groshësh.

⁵⁶ *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-14-1455, Raport i delegatit austro-hungarez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për ministrin e Punëve të Jashtme, Vlorë, 23 maj 1914.

⁵⁷ *Po aty*, Vj. 24-44-4492, Dispozitat shtesë për Himarën, hartuar nga Karapanosi dhe Zografosi për Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Vlorë, 23 maj 1914.

Ndërkombëtar të Kontrollit kundërshtoi përfshirjen e 18 fshatrave në lokalitetin e Himarës. Për të, krahina e Himarës përbëhej vetëm nga 7 fshatra. Sa i takon Spiromilos, Frashëri nuk pranoi që ai të konsiderohej unanimisht si kryetar i krahinës, pasi në Himarë ekzistonte edhe një grupim shqiptar që ishte kundra tij⁵⁸. Pavarësisht kundërshtimeve të delegatit shqiptar, më 23 maj 1914 anëtarët e tjerë të Komisionit vendosën t'ua bashkëngjisin Dispozitave të Korfuzit propozimet e përshtatura që Karapano dhe Zografi kishin bërë për krahinën e Himarës⁵⁹. Ato do t'i parashtroheshin për shqyrtim dhe miratim Fuqive të Mëdha dhe qeverisë shqiptare.

Në përpjekje për të ndryshuar strukturën fetare të Shqipërisë së Jugut

E drejta për të caktuar kufijtë e zonës së Korçës e të Gjirokastrës, që Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit fitoi në Dispozitat e Protokollit të Korfuzit, nxiti Zografon dhe Karapanon të kërkonin përjashtimin nga njësia e mësipërme territoriale të krahinave me popullsi shqiptare myslimane. Që në bisedimet e Korfuzit, ata kërkuan që Kurveleshi, Labëria dhe Starova, zona të pushtuara nga trupat grekë, të mos ishin pjesë e krahinës së Gjirokastrës dhe Korçës. Por, anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit nuk pranuan të merrnin ndonjë vendim në Korfuz, sepse ndarja administrative u konsiderua një çështje që kishte nevojë të shqyrtohej qetësisht⁶⁰. Në emër të qeverisë shqiptare, delegati Frashëri, refuzoi çdo ndryshim të ndarjes administrative⁶¹.

Kërkesa e autonomistëve për ndryshimin e ndarjes administrative i shërbente qëllimit për të ndryshuar strukturën fetare të Shqipërisë së Jugut. Synohej që aty të krijoheshin artificialisht një shumicë e krishtere, e cila nënkuptonte krijimin e një zone të pastër nga pikëpamja fetare, që sipas konceptit grek të kombësisë, nënkuptonte pastërti edhe etnike. Në diskutimet e Asamblesë Epirote, anëtarët e saj shfaqnin shqetësim për faktin se në prefekturat e Korçës dhe të Gjirokastrës popullsia e krishterë

⁵⁸ *Po aty*, Vj. 24-14-1455, Raport i delegatit austro-hungarez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për ministrin e Punëve të Jashtme, Vlorë, 23 maj 1914.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ *Po aty*, Vj. 24-14-1465, Raport i delegatit austro-hungarez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Korfuz, maj 1914.

⁶¹ *Po aty*.

nuk ishte në epërsi numerike ndaj asaj myslimane⁶². Ajo nuk ishte në raportet 3 me 4 ose 4 me 5 të popullsisë së përgjithshme të të dyja prefekturave⁶³. Bashkimi i krahinave të Starovës, Labërisë, Kurveleshit qoftë me Vlorën, qoftë me Elbasanin, siguronte zhvendosjen e shumicës së popullsisë shqiptare myslimane. Në këtë mënyrë, ortodoksët që mbeteshin aty, do të ishin të vetmit të përfaqësuar, si në Këshillat Lokalë, ashtu dhe në Asamblenë Kombëtare. Ata do të ishin zotër për të vepruar sipas mënyrës së tyre në dëm të “pakicës” së mbetur myslimane. Pas arritjes së marrëveshjes në Korfuz, autonomistët synuan që territoret jugore të shtetit shqiptar, të cilat tashmë do të kishin një administratë autonome, të qeveriseshin vetëm nga të krishterë grekë ose shqiptarë me ndjenja greke. Në rrethana më të volitshme kjo administratë do të kishte më shumë mundësi t’i aneksohej Greqisë.

Për të ruajtur epërsinë e elementit të krishterë, rikthimi i popullsisë myslimane konsiderohej se ishte i dëmshëm. Një shtesë sado e vogël e popullsisë myslimane e dëmtonte “shumicën” e krishterë. Në kërkesën për ndryshimin e ndarjes administrative, autonomistët pretendonin se kishin konsensusin e qeverisë greke. Sipas tyre, Greqia vuante pasojën e aplikimit të konceptit të rrumbullakosjes së popullsisë duke grumbulluar popullsi myslimane shqiptare, e cila mbarte në vetvete elementë shumë të rrezikshëm për të⁶⁴.

Krijimi i një zone me epërsi të dukshme të elementit të krishterë ishte një proces që kishte nisur me kohë në Shqipërinë e Jugut. Politika e ndjekur nga autoritetet greke të pushtimit, e vijuar nga qeveria e Zografos, synoi të dëbonte e masakronte popullsinë shqiptare, që frekuentonte besimin mysliman dhe të nënshtronte me forcë shqiptarët e krishterë, që manifestonin ndjenja kombëtare shqiptare. Veçanërisht, u

⁶² *AIH*, A.IV.296, Procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë Epirote në Delvinë, botuar në gazetën “Amyna” në muajt korrik, gusht, shtator të vitit 1915.

⁶³ Të dhënat statistikore të përdorura nga grekët për vitin 1913 japin një pasqyrë si më poshtë vijon: Popullsia në prefekturën e Korçës ishte 98.152 banorë. Nga këta shqiptarë [nënkupto myslimanë] ishin 53.684 banorë, grekë [nënkupto ortodoksë] ishin 44.468 banorë. Në prefekturën e Gjirokastrës popullsia e përgjithshme ishte 120.370 banorë. Nga këta shqiptarë (nënkupto myslimanë) ishin 53.500 banorë, grekë [nënkupto ortodoksë] ishin 66.870 banorë. Shih: *AMPJ*, V. 1944, D. B/VIII 3. Studim i Dhimitër Kolovanit mbi Epirin e Veriut. Aneksi 8.

⁶⁴ *AIH*, A.IV.296, Procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë Epirote në Delvinë, botuar në gazetën “Amyna” në muajt korrik, gusht, shtator 1915.

synua shkatërrimi i ndikimit të bektashinjve, të cilët kishin kontribuar shumë që të dështonte përpjekja për të mbjellë armiqësi fetare⁶⁵, dhe eliminimi i asaj pjese të popullsisë shqiptare që nuk mund të përpunohej, pavarësisht fesë që frekuentonte.

Në mënyrë të pashmangshme, situata e rëndë dhe e turbullt në Shqipërinë e Jugut solli largimin e popullsisë vendase në drejtim të zonave më të qeta. Numri i emigrantëve u rrit ndjeshëm, veçanërisht pas luftimeve në Korçë, në Kolonjë e në Leskovik. Për ta paraqitur gjendjen më alarmante dhe gjithmonë për efekt presioni pranë qeverisë shqiptare dhe Fuqive të Mëdha, Zografosi nxiti emigrimin jo vetëm të popullsisë shqiptare myslimane, por edhe të pjesës ortodokse të qytetit dhe rrethit të Gjirokastrës. Ngarkesa psikologjike e popullsisë u rëndua më shumë edhe nga deklaratat ekstremiste sipas të cilave “shqiptarët kanë për t’u bërë subjekte kasaphane, teksa kanë mbetur duarlidhur, pasi nëna Greqi i ka braktisur”⁶⁶. Ritmet e largimit të popullsisë u shtuan ndërkohë që në Korfuz numri i të emigruarve arriti në 500 veta⁶⁷. Por, procesi i emigrimit të popullsisë ortodokse u pa nga autoritetet greke, të ishte në kundërshtim me interesat e tyre kombëtarë⁶⁸. Shqetësimi për përmasat në rritje të emigrimit të popullsisë ortodokse u shpreh fillimisht në raportet që vinin nga terreni. Zëvendëskomandanti i përgjithshëm i Epirit, Angelos Forestis (Angelos Forestis), i trembej faktit se emigrimi përveçse do të ndodhte jashtë kujdesit të qeverisë mbretërore, do të sillte uljen e numrit

⁶⁵ J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie...*, f. 187.

⁶⁶ *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και Ελληνοαλβανικές Σχέσεις* (Grekët e Epirit të Veriut dhe marrëdhëniet greko-shqiptare) Επιμέλεια: Βασίλειος Κόντης (nën kujdesin e Vasil Kondis) Έγγραφα από το Ιστορικό Αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών (Dokumente nga Arkivi Historik i Ministrisë së Jashtme) Τόμος Ι, 1897-1918 (Vëllimi I, 1897-1918) *Εστιασ: Αθήνα, 2004*, f. 320-321, Komanda e Përgjithshme për Ministrinë e Jashtme, Janinë, 15\28 shkurt 1914.

⁶⁷ *HHS.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-2-204, Telegram i konsullit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë në Korfuz për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Korfuz:,14 maj 1914.

⁶⁸ *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου...*, Τόμος Ι, 1897-1918, f. 317-320, Komanda e Përgjithshme për Ministrinë e Jashtme, Janinë, 29 janar\10 shkurt 1914.

HHS.A.P.A.A. në *AIH*, Vj. 24-7-738, Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për ministrin e Punëve të Jashtme, Athinë, 6 mars 1914. Mbi takimin me mbretin e Greqisë; *Po aty*, Vj, 24-9-960, Telegram i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Athinë, 25 mars 1914. Mbi takimin me kryeministrin e Greqisë.

të popullatave të krishtera, gjë që në të ardhmen do të bëhej pengesë ndaj çdo veprimi të Greqisë në ato zona⁶⁹. Në këtë situatë, mbreti i Greqisë këshilloi autoritetet kufitare greke të mos e lejonin shndërrimin e tij në një proces masiv, ndërsa kryeministri grek deklaroi se kishte “frikë nga shtesa e popullsisë së atdheut që pritej të bëhej prej të arratisurve nga Epiri”⁷⁰.

Ndërkohë që, drejtuesit e shtetit grek po përpiqeshin të shmangnin emigrimin masiv të popullsisë së krishterë nga Shqipëria e Jugut, krerët e Lëvizjes Vorioepirote gjithnjë e më shumë po nxitnin dhunshëm, emigrimin e popullsisë shqiptare myslimane. E ashtuquajtura ushtri epirote shkatërroi e dogji fshatra të tëra me popullsi myslimane. Numri i tyre tejkaloi disa herë numrin e fshatrave me popullsi të krishterë të djegura gjatë Luftërave Ballkanike. Që në fund të marsit të vitit 1914, kryetari i qeverisë së vetëshpallur të Vorioepirit kishte urdhëruar të gjithë shqiptarët myslimanë të Gjirokastrës që të largoheshin brenda katër ditësh, sepse jeta e tyre do të ishte shumë e pasigurt prej sulmeve të andartëve të zemëruar⁷¹. Dhuna ndaj popullsisë shqiptare dhe plaçkitja e shtëpive të shqiptarëve u bënë fenomene të vazhdueshme dhe masive⁷². Veprimet e mësipërme ishin pasojë e dëshirës për të pakësuar me çdo çmim elementin shqiptar mysliman në Shqipërinë e Jugut⁷³. Me qëllim që t’i hiqnin popullsisë fatkeqe myslimane edhe mjetet e jetesës, bandat e andartëve dogjën edhe të korrat në ara. Veprimet barbare shkaktuan vdekjen në masë të grave dhe fëmijëve, të cilët nuk mundën ta përballonin dimrin pa ushqim e pa strehë⁷⁴. Në fund të qershorit të vitit 1914, autoritetet greke detyruan popullsinë shqiptare, kryesisht atë myslimane që kishte emigruar në tokën greke, të rikthehej në Shqipëri.

⁶⁹ *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου...*, Τόμος Ι, 1897-1918, f. 317-320, Komanda e Përgjithshme për Ministrinë e Jashtme, Janinë, 29 janar / 10 shkurt 1914.

⁷⁰ *HHSSt.A.P.A.A. në AIH*, Vj. 24-4-440, Raport i Legatës së Austro-Hungarisë në Athinë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Athinë, 25 prill 1914.

⁷¹ *Po aty*, Vj. 24-9-967, Njoftim i Konsullatës së Austro-Hungarisë në Janinë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Janinë, 26 mars 1914.

⁷² *Po aty*, Vj. 24-6-671, Telegram i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez, A. Kral, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Gjirokastrë, 27 mars 1914.

⁷³ *AMAE në AIH*, F. 151, fl. 984, Raport i delegatit francez në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Francës, Durrës, 2 maj 1914.

⁷⁴ J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie...*, f. 186.

Ajo iu ekspozua masakrave të forcave epirote⁷⁵. Gjatë periudhës maj-qershor 1914, shkrimet e gazetës “Epirus”, përçonin idenë e shkatërrimit, të bërjes gërmadhë të çdo gjëje, përpara se krahinat e Shqipërisë së Jugut t’i kalonin administratës shqiptare⁷⁶. Këtij qëllimi duhej t’i shërbente edhe ideja e hedhur në qarkullim për rikthimin e trupave grekë në territorin shqiptar. Në bashkëpunim me të, Zografoja do të vijonte keqtrajtimin e popullsisë shqiptare, duke e shtrënguar atë të largohej në mënyrë masive. Përmasën reale të vuajtjeve të shqiptarëve jugorë, na e jep raporti që përpiloi në terren, gazetari amerikan Uiliam Houard (William W. Howard), sekretar i Përgjithshëm i Fondit për Ndihmat e Shqipërisë. Sipas tij, që nga tetori i vitit 1913 e deri në qershor të 1914, ishin djegur ose hedhur në erë 35.000 shtëpi dhe kishin mbetur pa strehë plot 330.000 veta. Ishin vrarë, therur me bajoneta ose djegur plot 20.000 burra, gra e fëmijë. Ai arriti në përfundimin se grekët lakmonin Shqipërinë e Jugut. Shqiptarët ortodoksë dhe myslimanë ishin pengesë për realizimin e këtij qëllimi, prandaj duhej të vriteshin ose të dëboheshin⁷⁷.

Pavarësisht se zyrtarë të lartë grekë nuk pranuan përgjegjësinë e drejtpërdrejtë në përvijimin e kësaj politike, është e vështirë të mos i bësh ata përgjegjës. Krijimi i zonave të pastra nga pikëpamja fetare, që u shoqërua me emigrime masive dhe dhunë të skajshme ndaj popullsisë, ishte një proces, që u ndoq nga ushtritë pushtuese dhe mbështetësit e tyre në të gjithë Gadishullin e Ballkanit, gjatë Luftërave Ballkanike⁷⁸.

⁷⁵ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-8-841, Telegram i Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë për Ambasadën e Britanisë së Madhe në Vjenë, Vjenë, 2 korrik 1914.

⁷⁶ *Po aty*, Vj. 24-2-223, Gazeta “Epirus”. Materiali i transmetohet ministrit të Punëve të Jashtme nga Konsullata e Përgjithshme e Austro-Hungarisë në Janinë, 22 maj 1914.

⁷⁷ Edwin Jacques, *Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Tiranë: Lajmi i mirë (viti i botimit mungon), f. 389. Autori jep pjesë nga raporti i vitit 1914, i gazetarit amerikan Uiliam Houard.

⁷⁸ *Ethnic Minorities in the Balkan Studies*, 1860-1971, Volume 3, 1914-1923, Edited by Bejtullah Destani, London: Archive Edition, 2003, fl. 9-10, Raport i ministrit britanik në Athinë për Ministrinë e Jashtme, Athinë, 18 prill 1914, Trajtimi i popullsisë myslimane në Maqedoni nga administrata greke; fl. 63-66, Raport i ambasadorit britanik në Stamboll për Ministrinë e Jashtme, Stamboll, 6 maj 1914. Emigrimi i popullsisë myslimane nga Maqedonia dhe i popullsisë ortodokse nga Traka; fl. 138-143, Raport i zv./konsullit britanik në Manastir për Ministrinë e

Vështirë të besohet se një politikë e tillë ishte lokale, spontane dhe rastësore. Pa përjashtuar këtu ekzagjerimin në terren, përgjithësisht ajo ishte një ndërmarrje e gjerë, që sigurisht bëhej me mbështetjen e politikës⁷⁹.

Reagimi i shqiptarëve për Protokollin e Korfuzit: pranimi dhe ratifikimi i detyruar i tij

Nënshkrimi i marrëveshjes në Korfuz nuk u prit mirë as nga rrethet nacionaliste shqiptare, as nga qeveria shqiptare. Dispozitat e Korfuzit binin ndesh me Statutin Organik të Shqipërisë⁸⁰. Rrethet nacionaliste

Jashtme, Manastir, 25 maj 1914. Emigrimi i popullsisë myslimane dhe sjellja e grekëve ndaj saj.

⁷⁹ Një dëshmi e rëndësishme në lidhje me përgjegjësinë e politikës zyrtare greke për situatën dramatike në Shqipërinë e Jugut na vjen nga sekretari i princ Vidit, Duncan Armstrong (Duncan Heaton-Armstrong). Në cilësinë e një oficeri britanik, më 28 maj 1914 ai i drejtohej Ministrisë së Jashtme me ndërmjetësinë e ministrit britanik në Athinë, në lidhje me “sjelljen pa famë të qeverisë greke dhe krime të kryera nga ushtarët grekë në Epir”. Sipas tij “qeveria greke është tërësisht përgjegjëse për lëvizjet epirote, e cila është praktikisht një lëvizje greke dhe ka shumë pak mbështetës në vend, përndryshe forcat e ashtuquajtura kryengritëse konsistojnë kryesisht në grekë...”. Letra e sekretarit të princ Vidit gjendet e plotë në R. Gurakuqi, *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë...*, f. 197-198.

Pak muaj më vonë, në korrik, në një diskutim në Dhomën e Komunave, ishte një tjetër britanik, A. Herbert (Aubrey Herbert), që e akuzoi drejtpërsëdrejti qeverinë greke për bashkëpunim me makinerinë që kishte prodhuar situatën tragjike në Jug të Shqipërisë. Po në të njëjtin diskutim, numri një i diplomacisë britanike, Eduart Grei (Edward Grey) deklaroi se “ndonëse jam i bindur se Venizelosi dëshiron sinqerisht t’i parandalojë ndodhi të tilla, fakti që ato u detyrohen grekëve, sado që të jenë të papërgjegjshëm, duhet të krijojnë një përshtypje shumë të pafavorshme për qeverinë greke”. *AMPJ*, Viti 1948, D. 136, Raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme shqiptare për Shqipërinë e Jugut dhe marrëdhëniet shqiptaro-greke, fl. 25-29.

⁸⁰ Pavarësisht se anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit u munduan të shmangnin përplasjet që mund të kishte Protokollin e Korfuzit me Statutin Organik, ata nuk ia dolën. Sipas Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë, “në variantin përfundimtar nga 13 artikuj që kishte Protokollin e Korfuzit me Statutin nuk binin ndesh vetëm fraza e parë e artikullit 3, fraza e parë e artikullit 5 dhe 3, fjalët e para të artikullit 8. Mund të përdorej edhe artikulli 2, por me një rrezik të madh, mbasi ai do të kishte kuptimin e futjes së influencës greke”. Shih: *HHSSt.A.P.A.A.* në

shqiptare ngarkuan me përgjegjësi qeverinë shqiptare dhe Princin për zhvillimin e bisedimeve. Fakti se qeveria shqiptare pranoi bisedimet, u konsiderua prej tyre si tradhti. Edhe autoriteti i Vilhelm Vedit ra ndjeshëm, sepse “ai pranoi të zhvillonte bisedime me qeverinë kryengritëse të Epirit, si i barabartë me të barabartin”⁸¹. Ata kundërshtuan veçanërisht lëshimet për Himarën dhe ndryshimin e ndarjes

AIH, Vj. 24-8-854, Notë e Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë për Ambasadën perandorake të Gjermanisë në Vjenë. Vjenë, 8 korrik 1914.

Protokolli pati përplasje me Statutin në çështjen e kufijve, xhandarmërisë dhe gjuhës.

Kufijtë: Statuti Organik i Shqipërisë në artikullin 67 paragrafi 8 dhe artikulli 98, 99, parashikonte se kufijtë e të gjitha sanxhaqeve të Shqipërisë do të caktoheshin me ligj. Projektligji lidhur me caktimin e kufijve administrative paraqitej nga Ministria e Brendshme e Shqipërisë në sesionin e parë të Asamblesë Kombëtare. Kufijtë administrative mund të ndryshoheshin veçse me një ligj të aprovuar nga Asambleja Kombëtare. Protokolli i Korfuzit vendoste krejt ndryshe. Artikulli 3 i tij vendoste që çështja e kufijve të Korçës dhe Gjirokastrës do të caktohej jo më nga autoritetet shqiptare, por nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Ndryshimi eventual i tyre do të bëhej vetëm me pëlqimin e Fuqive të Mëdha.

Xhandarmëria: Artikulli 150 i Statutit Organik ia ngarkonte organizimin e xhandarmërisë shqiptare, oficerëve holandezë. Në Protokollin e Korfuzit, në artikullin 5 dhe 6 parashikohej që xhandarmëria e dy sanxhaqeve të ishte e pavarur nga qeveria e Durrësit. Organizimi i saj “do të bëhej prej oficerëve, nënoficerëve dhe policëve vendas në raport me popullsisë ortodokse dhe myslimane nën drejtimin e oficerëve holandezë”. Pavarësisht se në artikujt e mësipërm deklarohesh se nuk prekej uniteti i xhandarmërisë shqiptare, në esencë sovraniteti i shtetit shqiptar, ishte kufizuar.

Gjuha: Artikulli 26 i Statutit Organik përcaktonte qartë se gjuha e vendit ishte shqipja. Vetëm në formë ndihme dhe provizorisht do të lejohej përdorimi i gjuhëve të tjera. Në artikullin 179 lejohej që mësimi fetar të bëhej në gjuhën e kultit. Në Protokollin e Korfuzit gjuha shqipe dhe ajo greke viheshin në shkallë të barabartë si gjuhë zyrtare që do të përdroreshin nga autoritetet e të dyja prefekturave. Ndërsa në shkollat e komuniteteve ortodokse arsimit do të bëhej në greqisht. Në tri klasat fillore, së bashku me greqishten do të mësohej edhe gjuha shqipe, por mësimi fetar do të bëhej vetëm në greqisht. Ky nen afirmonte politikën arsimore të përdorur nga osmanët, sipas së cilës shqiptarët e krishterë shkolloheshin në gjuhën greke dhe hidhte poshtë të gjitha përpjekjet e shqiptarëve ortodoksë për t’u shkolluar në gjuhën amtare. Shih: T. Dilo, *Invazionet greke.....*, dorëshkrimi në *AIH*.

⁸¹ *AMAE* në *AIH*, F. 152, fl. 143-145, Raport i konsullit të Francës në Korfuz për kryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Dumerg, Korfuz, 22 maj 1914.

administrative⁸². Në Korçë dhe Gjirokastrë rrethet nacionaliste shqiptarë përsëritën kërkesat e tyre për armatime dhe fuqi ndihmëse.

Qeveria shqiptare u gjend midis dy zjarreve. Nga njëra anë rrethet nacionaliste shqiptare dhe nga ana tjetër ndërkombëtarët. Ajo u përpoq të gjente një ekuilibër mes dy krahëve. Në kohën e zhvillimit të bisedimeve në Korfuz, ajo lejoi të mbahej një manifestim popullor kundër bisedimeve me epirotët⁸³ dhe vendosi të thërriste sërish rezervistët nën armë për të mbrojtur kufijtë jugorë të shtetit shqiptar⁸⁴. Për të lehtësuar këtë veprim, Abdi Toptani u emërua komandant i batalionit të Tiranës.

Fill pas përfundimit të bisedimeve në Korfuz, qeveria shqiptare u gjend nën trysinë e Fuqive të Mëdha për të pranuar integralisht Protokollin. Përfaqësuesit e tyre në Durrës filluan “t’i shpjegonin imtësisht Turhan Përmetit se në situatën e tanishme dyshimet eventuale kundër disa dispozitave të kompromisit duhet të largohen, në mënyrë që çështja epirote të rregullohet pa vonesë”⁸⁵. E dobët të kundërshtonte vullnetin e Fuqive të Mëdha, pavarësisht se Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit kishte tejkalar “Dëshiresën” e saj, më 5 qershor 1914 qeveria shqiptare deklaroi se do t’i pranonte propozimet e bëra prej Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në bisedimet e Korfuzit⁸⁶. Pranimi i qeverisë shqiptare u referohej vetëm 13 artikujve bazë të Dispozitave të Korfuzit dhe jo neneve shtesë të tij, që lidheshin me Himarën.

Më 14 qershor 1914, Mehdi Frashëri i dorëzoi Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit deklaratën e pranimi të qeverisë shqiptare⁸⁷. Ndonëse Komisioni e konsideroi pranimin si integral dhe pa kushte, qeveria shqiptare në rreshtat e fundit të deklaratës e kishte kushtëzuar pranimin me kushtin që “zbatimi i dispozitave të Korfuzit nuk duhet të

⁸² *Ethnic Minorities in the Balkan Studies, 1860-1971*, vol. 3..., fl. 110-115, Raport i H. Lemb për Ministrinë e Jashtme, Durrës, 25 maj 1914.

⁸³ *AIH*, A-V-55, Kujtimet e Syrja bej Vlorës.

⁸⁴ M. Frashëri, *Kujtime...*, f. 13.

⁸⁵ *HHSSt.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 24-9-970, Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për Legatën në Durrës dhe Ambasadat në Londër, Romë, Paris, Berlin, Peterburg, Vjenë, 2 qershor 1914.

⁸⁶ *Po aty*, Vj. 24-9-975, Raport i delegatit të Austro-Hungarisë në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Durrës, 5 qershor 1914.

⁸⁷ *Po aty*, Vj. 24-41-4135, Deklarata e qeverisë shqiptare për Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit në lidhje me Dispozitat e Korfuzit, Durrës, 14 qershor 1914.

dëmtojë zhvillimin kombëtar dhe unitetin e Shqipërisë”⁸⁸. Prej deklaratës kupton se qeveria e Durrësit përpiqej të influenconte tek Fuqitë e Mëdha në tri çështje: në ndarjen administrative, privilegjet e bashkësisë ortodokse dhe emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve të lartë⁸⁹. Për çështjen e parë, qeveria shqiptare besonte se “Fuqitë e Mëdha nuk do të lejojnë një ndarje administrative të ndryshme nga ajo që është pranuar më parë në Statutin Organik, të përfunduar nga vetë Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit”. Në lidhje me të dytën, ajo, pasi tërhiqte vëmendjen e Fuqive të Mëdha se “çështja e kulteve ishte trajtuar në Statutin Organik, në një frymë sa të gjerë, aq edhe liberale në favor të bashkësive ortodokse” [Kap. XI, paragrafi 170 e në vazhdim], kërkonte prej tyre ta konsideronin “nenin 7 të marrëveshjes së Korfuzit, si diçka të tepërt”. Qeveria shqiptare ua linte Fuqive të Mëdha kujdesin për të rregulluar raportet me Patrikanën e Kostandinopojës. Për sa i përket çështjes së tretë, qeveria shqiptare shprehte dëshirën që paragrafi i parë i Dispozitave të Korfuzit, i cili kishte të bënte me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve të lartë të dy krahinave, “të konceptohet në një mënyrë të tillë që të mos preket dinjiteti dhe prerogativat e qeverisë shqiptare, si dhe funksionimi i rregullt i të gjitha degëve të administratës”⁹⁰.

Pas pranimit të Protokollit të Korfuzit nga qeveria shqiptare, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit priste vetëm aprovimin e Fuqive të Mëdha. Ai pretendonte të fillonte nga data 20 qershor udhëtimin në Jug, për të vënë në zbatim Dispozitat e Korfuzit⁹¹.

Shqipëria nuk e ratifikoi menjëherë Protokollin e Korfuzit, me shpresën se situata në Shqipërinë e Jugut do të përmirësohej. Ratifikimi i Protokollit u bë më 23 qershor 1914. Po në të njëjtën ditë Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit i dorëzoi dokumentin zyrtar qeverisë së

⁸⁸ *Po aty*, Vj. 24-9-975, Raport i delegatit të Austro-Hungarisë në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Durrës, 5 qershor 1914.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ *Po aty*, Vj. 24-41-4135, Deklarata e qeverisë shqiptare për Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit në lidhje me Dispozitat e Korfuzit, Durrës, 14 qershor 1914.

⁹¹ *Po aty*, Vj. 24-9-975, Raport i delegatit të Austro-Hungarisë në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Durrës, 5 qershor 1914.

Zografosit, në të cilin ishin shmangur rezervat e qeverisë shqiptare⁹². Me kalimin e ditëve situata nuk njohu përmirësim, ajo vetëm u përkeqësua. E ndikuar prej saj, qeverisë shqiptare iu desh të lëshonte më shumë. Në fillim të korrikut të vitit 1914, ajo pranoi që për çështjet e mbetura pezull në Korfuz, vendimi efektiv të bëhej nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit⁹³. Në këtë mënyrë çështja e Himarës i mbetej në dorë vullnetit të anëtarëve të tij.

Për studiuesin britanik, J. Suajer (J. Swire), fakti që qeveria shqiptare i pranoi dhe më pas i ratifikoi dispozitat e Protokollit të Korfuzit, nuk mund të interpretohet si pranim nga ana e Shqipërisë, që Jugut të kishte të drejtën e një administrate autonome⁹⁴. Qeveria shqiptare nuk kishte alternativë tjetër. Kundërshtimi i Protokollit do ta përballte atë jo vetëm më Fuqitë e Mëdha por edhe me Greqinë, një luftë me të cilën ajo nuk mund ta përballonte për dy arsye. *Së pari*, për shkak të situatës së rënduar ndërkombëtare. Pragu i Luftës së Parë Botërore dhe marrëdhëniet e acaruarra deri në pikën e prishjes ndërmjet Austro-Hungarisë e Italisë nuk e favorizonin hapjen e një fronti mes Shqipërisë dhe Greqisë. Pa mbështetje, qeveria shqiptare nuk mund ta përballonte një luftë me fqinjin e saj jugor. *Arsyeja e dytë*, por jo më pak e rëndësishme lidhet me rëndimin e situatës së brendshme, për shkak të rebelimit në Shqipërinë e Mesme⁹⁵.

E paaftë për të shtypur rebelimin dhe me shpresë se do të çlirohej prej presionit të vorioepirotëve, qeveria shqiptare ratifikoi Protokollin e Korfuzit. Me këtë veprim ajo shpresonte t'i jepte fund veprimeve të armatosura në Jug duke përqendruar forcat e veta në Durrës, për t'i bërë ballë rebelimit⁹⁶.

⁹² V. Kondis, *Greqia dhe Shqipëria...*, f. 76.

⁹³ *HSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-1-168, Raport i delegatit të Austro-Hungarisë në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Durrës, 11 korrik 1914.

⁹⁴ J. Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie...*, f. 173.

⁹⁵ Për rebelimin në Shqipërinë e Mesme shih: *Historia e Popullit Shqiptar*. Vëllimi III, Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912-7 prill 1939, Tiranë: "Toena", 2007, f. 64-68; A. Puto, *Shqipëria Politike, 1912-1939*, Tiranë: "Toena", 2009, f. 138-148; Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: "Kristalina-KH", 2007, f. 67-78.

⁹⁶ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f. 77.

Nga gërshetimi i ngjarjeve në pranverë-verë të vitit 1914, kupton se të gjithë kundërshtarët e pavarësisë së Shqipërisë rastësisht apo të parapërgatitur, vepruan në harmoni të plotë. Projektet e vjetra për copëtimin e Shqipërisë dolën sërish në dritë. Dokumentacioni i kohës dhe letërsia historike evidenton jo vetëm rolin e Xhonturqve, por edhe bashkëpunimin e tyre me serbët dhe grekët⁹⁷. Në fund të pranverës së vitit 1914, marrëdhëniet osmano-greke po jetonin një periudhë qetësie. Me ndërmjetësinë e Britanisë së Madhe vijonin përpjekjet për t'i ulur krerët më të lartë të të dyja shteteve në tavolinën e bisedimeve⁹⁸. Ecuria pozitive e përpjekjeve diplomatike krijoi një frymë bashkëpunuese edhe në terren. Sipas raportit të ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë, i cili citon një material të përgatitur për qeverinë bullgare, që tre muaj

⁹⁷ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-28-2858, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 4 qershor 1914; *Po aty*, Vj. 24-22-2276, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 18 qershor 1914; *Po aty*, Vj. 24-20-2083, Raport i nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Vlorë për përfaqësuesin e Austro-Hungarisë në Durrës, Vlorë, 25 qershor 1914; *Po aty*, Vj. 24-28-2858, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 4 qershor 1914.

⁹⁸ Në prill 1914 qeveria osmane i kishte propozuar Athinës shkëmbimin e popullsisë rurale të distriktit të Trakës dhe Smirnës me myslimanët e Maqedonisë dhe të Epirit. Me ndërmjetësinë e Gjermanisë e pas saj, edhe të Britanisë së Madhe, Perandoria Osmane kishte pranuar të hynte në bisedime me Greqinë. Bisedimet do të zhvilloheshin mes Venizelosit dhe Vezirit të Madh, në bazë të formulës së propozuar nga qeveria greke. Sipas saj tre ishujt e detit Egje do të qëndronin nën sovranitetin grek, por do të gëzonin një administrim autonom nën princin Pol, djali i dytë i mbretit të Greqisë, i cili, si guvernator i përgjithshëm, duhej të pranohej si nga Perandoria Osmane, ashtu edhe nga Greqia. Në mes të qershorit të vitit 1914 kryeministri grek u nis për në Bruksel ku do të takohej me Vezirin e Madh. Takimi nuk u bë, sepse Austro-Hungaria i deklaroi luftë Serbisë. Me sugjerimin e qeverisë rumune, Greqia dhe Perandoria Osmane ranë dakord të dërgonin përfaqësuesit e tyre në Bukuresht për të zhvilluar bisedime. Takimi u realizua në kryeqytetin rumun nga data 12 deri 29 gusht të vitit 1914. Greqia propozoi që Perandoria të mbante sovranitetin e ishujve dhe t'ia jepte me qira Greqisë për një periudhë prej 25 vjetësh. Perandoria Osmane nuk pranoi asnjë lëshim. Negociatat u mbyllën pa rezultat. Kriza në marrëdhëniet osmano-greke vazhdoi. Për më shumë shih: N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Paris Peace Conference (1919)*, Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1978, f. 29-31; George B. Leon, *Greece and the Great Powers, 1914-1917*, Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1974, f. 13-14.

përpara se të shpërthente rebelimi i Shqipërisë së Mesme, Sofja zyrtare ishte informuar se Esad pashë Toptani së bashku me faktorë të tjerë po përgatitej të rrëzonte Vidin⁹⁹. Marshimi kërcënues në Shijak, më 17 maj 1914, ishte një komedi e akorduar mes Xhonturqve dhe ministrit Toptani, që ishte në shërbim të Serbisë dhe në kontakt me Greqinë, me anë të kumatit të tij Hamdi Beut, i konsideruar një vegël qorre e mitropolitit të Durrësit. Realizimi me sukses i grushtit të shtetit do t'i siguronte Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë përfitime të rëndësishme territoriale, ndërsa ministrit shqiptar ndihmën e shteteve fqinje për sundimin e tij në Shqipërinë e Mesme¹⁰⁰.

Edhe për diplomatët austro-hungarezë në Durrës e në Vlorë mundësia për ekzistencën e një plani të përbashkët copëtimi të marrë vesh më parë, ishte e madhe. “Greqia do Epirin, Italia do Vlorën, Serbia një liman në detin Adriatik, Mali i Zi do Shkodrën, Perandoria Osmane sovranitetin e shtetit të vogël shqiptar në Shqipërinë e Mesme dhe, në qoftë se jo qeveritë, të gjithë të tjerët duke përfshirë këtu grupet militare nën patronazhin e fshehtë të Rusisë dhe Francës, kanë gjetur njëri-tjetrin nën urrejtjen e përbashkët kundra Austro-Hungarisë dhe kënaqësinë djallëzore për të shkatërruar Shqipërinë, të cilën e konsiderojnë si krijesën e saj. Kjo e fundit, e vobektë nga kushtet më të nevojshme për ekzistencë dhe e shkretuar nuk është në gjendje t’u bëjë ballë këtyre intrigave”¹⁰¹.

Pavarësisht se ku u ngjiz dhe kush e ngjizi rebelimin, skenari siguronte mbështetës të shumtë në Durrës dhe më gjerë. Raportet diplomatike austro-hungareze flasin për rol aktiv të ministrit grek Varatasi, të ngarkuarit me punë të Serbisë Gavriloviç, mitropolitit të Durrësit Jakovi, ministrit të Rusisë, Italisë dhe Francës¹⁰². Ky rreth çuditërisht ishte shumë i informuar mbi dëshirat e rebelëve dhe tregonte për ta një konsideratë të admirueshme.

⁹⁹ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-24-2439, Raport i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 22 maj 1914.

¹⁰⁰ *Po aty*.

¹⁰¹ *Po aty*, Vj. 24-21-2135, Raport i përfaqësuesit të Austro-Hungarisë në Durrës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Durrës, 30 qershor 1914.

¹⁰² *Po aty*; *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-20-2083, Raport i nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Vlorë për ministrin e Austro-Hungarisë në Durrës, Vlorë, 25 qershor 1914.

Vetë rebelët nuk ngurronin ta deklaronin bashkëpunimin me Greqinë. Në një letër drejtuar popullit të Beratit, më 3 korrik 1914, ata shpreheshin se: “Veprimtaria e Greqisë dhe e epirotëve drejtohet kundër qeverisë së Vidit. Veprimtaria jonë përputhet dhe bashkohet me politikën e Antantës Trepalëshe. Përkrahja e Greqisë është e siguruar”¹⁰³. Në këtë kuadër, rebelët pretendonin dërgesa të hollash nga ana e Manastirit, prej palës greke¹⁰⁴. Edhe të dhënat e ministrit italian në Durrës, Alioti (Aliotti), bënin me dije se në krahinat kryengritëse kishin hyrë në mënyrë të dukshme shumë monedha të fabrikuara në Greqi, shpërndarjen e të cilave e kishte bërë vllahu i greqizuar, Voilla¹⁰⁵.

Greqia kërkoi të nxirrte të gjitha përfitimet e mundshme nga situata e krijuar. Shpërthimi i rebelimit në Shqipërinë e Mesme në të njëjtën kohë me përpjekjen e qeverisë shqiptare për të mbrojtur kufijtë shtetërorë jugorë, i shkonte për shtat qëllimit të saj për të penguar aksionin ushtarak të forcave shqiptare kundër “trupave epirotë”. Ndonëse zyrtarisht Greqia përkrahte Vidin, në mënyrë të kamufluar ajo inkurajoi rebelimin në mënyrë që shteti shqiptar të dobësohej dhe të mos kishte mundësi t’i kundërvihej qeverisë së “Vorio-Epirit”¹⁰⁶. Për delegatin shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit Mehdi Frashërit, ministri Varatasi, me ndërmjetësinë e mitropolitit të Durrësit dhe Voillës, fuste zjarr e fanatizëm midis myslimanëve, për një kryengritje kundër princ Vidit. Ata donin të pengonin qeverinë shqiptare të grumbullonte fuqi për t’i çuar në Korçë e Gjirokastrë¹⁰⁷. Përkeqësimi i gjendjes në Shqipërinë e Mesme detyroi në fillim të qershorit, qeverinë shqiptare të urdhëronte njësitë e xhandarmërisë dhe vullnetarët nga lokalitetet e Jugut, të zhvendoseshin drejt Durrësit, për të përballuar atë që po ndodhte në kryeqytet¹⁰⁸. Ky veprim sigurisht që u dha dorë forcave “epirote” duke i bërë ata mbizotërues të situatës në Shqipërinë e Jugut. Në këtë mënyrë

¹⁰³ *Po aty*, Vj. 24-44-4457, Letër e rebelëve drejtuar popullit të Beratit, 3 korrik 1914.

¹⁰⁴ *Po aty*, Vj. 24-24-2497, Raport i nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Vlorë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Vlorë, 6 shtator 1914.

¹⁰⁵ *Po aty*, Vj. 24-21-2135, Raport i përfaqësuesit të Austro-Hungarisë në Durrës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Durrës, 30 qershor 1914.

¹⁰⁶ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f. 76.

¹⁰⁷ M. Frashëri, *Kujtime...*, f. 10.

¹⁰⁸ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 24-27-2772, Telegram i përfaqësuesit të Austro-Hungarisë në Durrës për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Durrës, 8 qershor 1914.

çështja e aneksimit të Shqipërisë së Jugut mbeti e hapur. Qeveria shqiptare vazhdoi ta konsideronte Greqinë në krah të epirotëve dhe me ndikim tek ata.

Para se të lëshohej urdhri për zhvendosjen e njësisë shqiptare në drejtim të Durrësit, kryeministri shqiptar i kërkoi ministrit të Greqisë në Durrës, të kontaktonte qeverinë e tij me shpresën se ajo mund “të garantonte që epirotët nuk do të ndërmerren një lëvizje, nëse qeveria shqiptare tërhiqte forcat e saj nga Jugu”. Por, qeveria greke nuk pranoi të ndërhynte në të ashtuquajturën çështje epirote¹⁰⁹, duke e lënë situatën të përkeqësuar edhe më shumë. Në sytë e kancelarive ndërkombëtare Athina e paraqiti rebelimin si lëvizje pro-osmane, të drejtuar kundër krishterimit. Politika greke synoi kështu të nxiste dallimet dhe pakënaqësitë fetare në Shqipëri. Në këtë mënyrë ajo me një gur vriste dy zogj: edhe poshtëronte shqiptarët edhe e kishte më të lehtë të realizonte qëllimet e saj aneksioniste në drejtim të Jugut të Shqipërisë¹¹⁰.

S u m m a r y

TITULLI

The arrival of the German Prince, William of Wied, in Albania did not change the situation in the south of the country. The North Epirot movement, which aimed at resisting the decisions of the Great Powers about the inclusion of the regions of Korca and Gjirokastra within the Albanian state, continued its activity. The aggravated situation in South Albania and the pressure exercised by the international community to start negotiations in order to bring an end to the conflict, made the Albanian government return to negotiations through the International Commission of Control (ICC). On 6th May 1914 the Albanian government authorized the ICC that on its behalf start negotiations with the self proclaimed Northern Epirot government. The Albanian government handed over to the ICC the proposals which should have been the basis for the negotiations. The ICC accepted to conduct the negotiations with the “Northern

¹⁰⁹ *AQSH*, F. 486, V. 1914, D. 57, fl. 81-83, Raport i delegatit të Rusisë në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Durrës, 17 qershor 1914.

¹¹⁰ V. Duka, *Histori e Shqipërisë...*, f. 76.

Epirots”, an action which was in accordance with the functions and jurisdiction of this Commission.

The negotiations between the ICC and the self proclaimed Northern Epirot government ended in the signing of an agreement, known as the Corfu Protocol, on the 17th May 1914. The Protocol was the result of the Great Powers attempts to find a compromise that would bring stability to South Albania and at the same time please Greece. According to the agreement, the Albanian state took under its control the territories of South Albania, while Greece succeeded in its “Hellenic Question”. Although in the Protocol’s dispositions was reconfirmed the territory of Albania, the regions in the south were granted administrative autonomy. The Protocol officially recognized the Northern Epirot population as differed from the rest of the Albanian population in the region, and Greece gained the right to represent this population’s interests.

Right after the negotiations had ended the Albanian government became subject to the Great Powers’ pressure to accept the Corfu Protocol as a whole. The Albanian government, weak to resist the Great Powers’ will, although the ICC had gone beyond its proposals and the disposals of the Protocol contradicted with the Organic Statute of the Principality, on 5th June 1914 stated that it would accept the proposals of ICC. Hoping that the situation in South Albania would improve, Albania postponed the ratification of the Corfu Protocol. However, its hopes were in vain as the situation deteriorated as a result of the Middle Albania rebellion. Unable to suppress it and hoping to be relieved from the northern epirot pressure, the Albanian government ratified the Corfu Protocol on 23th June 1914.